

Këshilli i ndarjes së Çmimit shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” shpall

K O N K U R S

për ndarjen e Çmimit shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” për vitin. 2025

Me çmimin shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” jepet mirënjohja më e lartë për realizimet shumëvjeçare në fushën e edukimit, arsimit, kulturës, artit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit njerëzor dhe në veprimtarinë shoqërore.

Çmimi shtetëror u ndahet individëve, grupeve të krijuesve, ekipeve, institucioneve, shoqërive tregtare dhe shoqatave të qytetarëve.

Çmimi shtetëror mund t'u ndahet shtetasve të huaj, grupit të krijuesve, ekipeve dhe institucioneve nga jashtë për realizimet shumëvjeçare që janë me interes publik për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Individit të shpërblyer i ndahet diplomë dhe shumë të hollash.

Çdo anëtar i të grupit krijuesish të shpërblyer ose ekipit i ndahet diplomë dhe pjesë e barabartë e shumës së të hollave.

Institucionit, shoqërisë tregtare ose shoqatës së qytetarëve, të shpërblyer, i ndahet diplomë dhe një pllakë.

Shuma monetare e çmimit shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” është dhjetë (10) paga mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paguara në tre muajt e fundit të vitit aktual.

Çmimi shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” ndahet, me rregull, çdo vit.

Brenda një viti mund të ndahen deri në pesë (5) çmime.

Iniciativë për ndarjen e çmimit shtetëror „Sh. Kliment Ohridski” mund të dorëzohen nga: institucionet, shoqëritë tregtare, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e çmimit shtetëror duhet të arsyetojnë iniciativën në detaje. Teksti duhet të përmbajë edhe: të dhëna precize biografike, adresën e saktë të vendbanimit (adresën e rrugës, numrin, vendin, qytetin, shtetin), të dhëna për rezultatet e realizuara në fushën në të cilën është arritur realizimi dhe të dhëna të tjera që konsiderohet që do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtruesi i iniciativës duhet të shënojë emrin dhe mbiemrin e tij të plotë, titullin, kompaninë, adresën dhe numrin e telefonit.

Teksti i iniciativës (i plotësuar) të dorëzohet në 20 kopje, dhe punimet (libra, botime etj.) trajtohen si shtojca dhe duhet të dorëzohen në një (1) kopje.

Adresa në të cilën duhet të dorëzohen iniciativat është:

Ministria e Kulturës dhe e Turizmit e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshilli i ndarjes së Çmimit shtetëror, „Sh. Kliment Ohridski”, rr. “Gjuro Gjakoviq” nr. 61 - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Konkursi zgjat nga 1 deri më 30 qershor 2025.

Iniciativat e pa kompletuara dhe iniciativat dhe shtojcat (punime, libra, botime etj.) të dorëzuara pas afatit për pranim në konkurs nuk do të shqyrtohen.

**Këshilli i ndarjes së Çmimit shtetëror
„Sh.Kliment Ohridski”**